



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:080384

Datë: 06.05.2019

Numri i dokumentit: 00300177

P.nr.244/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit T... N..., nga Gj..., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 1 të KPRK-s, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.355/2019, të datës 18.03.2019, të cilën e përfaqëson prokurori Shefik Memeti, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 02.05.2019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri T.. N... nga i ati Q... dhe e ëma Sh..., e lindur T..., i lindur më..., në Gjilan, rr. “...me numër personal..., ka të kryer shkollën mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, më parë i dënuar për vepër të njejtë penale dhe udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 23.02.2019, rreth ores 23,30 min, në Lagjen “....., Njësia e Trafikut Regjional, gjatë kontrollimit rutinorë, ka ndalur veturën me targa të regjistrimit..., të cilën e drejtonte..., me të cilën ishin edhe 4 (katër) bashkëudhëtar, dhe gjatë kontrollimit fizik të tyre te i pandehuri është gjetur substancë narkotike e llojitdhe një..., ku substanca narkotike dhe ... janë sekuestruar dhe njësia e DHTN-s, dhe se pas matjes e ekzaminimit të substancës së dyshuar narkotike, ka rezultuar se substanca narkotike e gjetur te i pandehuri është e llojit “...” dhe peshon..., kështu që substanca narkotike dhe thika janë sekuestruar, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta, pa leje dhe autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit.....,

-me çka ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 1 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 46, 50, 51, 73, 74 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurin,

E G J Y K O N

Të pandehurit, i caktohet dënim kumulativ me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Dhe dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 90 ditë pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtim me të pandehurin zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20.00 € (njëzet euro) ndërsa nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20.00 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Në bazë të nenit 275 paragrafi 3 të KPRK-s, **KONFISKOHET** substanca narkotike e llojit Marihuanë me peshë 0.9 gram dhe një brisk (patentë) të sekuestruar.

Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € (njëzetë euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1. Rrjedha e çështje

Prokuroria Themelore në Gjilan, me datë 18.03.2019, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 355/2019, kundër të pandehurit....., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 1 të KPRK-s. Në shqyrtimin fillestar në të cilin ishin prezent Prokurori i Shtetit, Shefik Memeti, dhe i pandehurinë të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzë deklaroi se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit ...për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehurika kryer veprën Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 1 të KPRK-s, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të pandehurinpër shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 1 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njëjti e ka pranuar edhe vet.

Në nenin 275 paragrafi 1 të KPRK-s, vepra penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge konsiderohet:

1. Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim kumulativ me kusht dhe me gjobë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që të pandehuritsi rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se i njëjti është penduar dhe ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka konsideruar posedimin e substancës narkotike, përgjegjësia penale dhe rrezikshmëria shoqërore.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit..., duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit. Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi Konfiskimin

Në bazë të nenit 275 paragrafi 3 i KPRK-s, është konfiskuar substanca narkotike e llojit ... me peshë ...e sekuestruar dhe.....).

8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurve, gjykata, duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.244/2019 - Më datë 02.05.2019

Sekretarja Juridike
Fatmire Sermaxhaj d.v
d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.